

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-209/13

Prishtinë, 8 Korrik 2015

Në çështjen juridike të:

Komuna e Podujevës

Podujevë

Pala ankuese

Përfaqësues: Xh. R., avokat
Podujevë

Kundër

R. R. I.

Kurshumli
Serbi

Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi i kërkesës

dhe kundër

Ndërmarrja Shoqërore Kooperativa Bujqësore P.i
Podujevë

Pala përgjegjëse në ankesë/në kërkesë 1

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredimi, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me aneksen kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nr. KPCC/D/A/187/2013 të datës 13 shkurt 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin. KPA38112), në tekstin e mëtejme po ashtu: Vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit të mbajtur më 8 Korrik 2015, mori këtë

AKTGJYKIM:

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Komunës së Podujevës kundër vendimit të **KKPK-së nr. KPCC/D/A/187/2013**, të datës 13 shkurt 2013, për sa i takon kërkesës nr. **KPA38112** (ngastra nr. **238/1**, zona kadastrale e Livadicës).
2. Konfirmohet vendimi i **KKPK-së nr. KPCC/D/A/187/2013** qe i referohet kërkesës nr. **KPA38112**.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 29 tetor 2007, pala përgjegjëse në ankesë/paraqitësi i kërkesës (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse ne ankesë) R. R. I. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së tij pronësore dhe ri-posedimin e një ngastër toke në Livadicko Polje, Komuna e Podujevës, zona kadastrale Livadicë, me numër 238/1, arë e klasës 4, pronë komerciale pa ndërtesa (tokë apo pyll), me sipërfaqe prej 88.90 ari (në tekstin e mëtejme: pronë e kërkuar). Ai deklaron se nëna e tij A. I. (në tekstin e mëtejme: nëna e palës përgjegjëse në ankesë), në atë kohë ishte bartëse e së drejtës pronësore dhe ajo e kishte humbur posedimin e pronës së kërkuar për shkak të rrethanave të luftës në vitet 1998/1999 më 18 qershor 1999. Ai më tej deklaron se ngastra ishte uzurpuar nga një person i panjohur i cili e kishte marrë tokën në shfrytëzim nga Komuna e Podujevës.
2. Pala përgjegjëse në ankesë ka dorëzuar në AKP mes tjerash edhe:
 - a) Fletën poseduese dhe kopjen e planit, të datës 24 korrik 2007, nr. 160 (Komuna e Podujevës; komuna kadastrale e Livadicës. Sipas fletës poseduese pjesa prej 1/1 pjesë ideale e ngastrës nr. 238/1 (88.90 ari), pronë e kërkuar, është në emër të A.I.;
 - b) Aktgjykimin e Gjykatës Komonale të Kurshumlisë, nr. P.br. 44/95, të datës 25 mars 1996. Me aktgjykim është vendosur se kontrata e datës 17 korrik 1967, e lidhur ndërmjet Kooperativës Bujqësore Sloga, tani P., dhe të ndjerit J.N. për shitblerjen e paluajtshmërisë është anuluar dhe se Përparimi ishte i obliguar që të dorëzojë – mes tjerash – ngastrën kadastrale 238/1 në Livadicë (pronën e kërkuar) në posedim të A. I. dhe pesë trashëgimtarëve tjerë ligjor të J. N.;
 - c) Vendimin e Entit Republikan për Gjeodezi, Pronë të Paluajtshme dhe Shërbim Kadastrale të Republikës së Serbisë, të datës 4 mars 1997, nr. 952-02-2/97-124-134 mbi

ndarjen e pronës. Sipas vendimit ngastra 238/1 (prona e kërkuar) është e regjistruar në emër të A. I. dhe pesë personave tjerë;

- d) Certifikatën e vdekjes së Komunës së Korshumlisë, Serbi, nr. 412/2002, të datës 24 2002. Sipas kësaj certifikate, A. I. kishte vdekur më 7 prill 2002;
 - e) Vendimin mbi trashëgiminë të Gjykatës Komunale të Korshumlisë, Serbi, nr. O.br. 79/2002, të datës 28 qershor 2002. Sipas këtij vendimin, pala përgjegjëse në ankesë, i biri i A. I., kishte trashëguar mes tjerash edhe pronën e paluajtshme në fletën poseduese nr.160 (Komuna e Podujevës; komuna kadastrale e Livadicës) ngastra nr. 238/1.
3. Të gjitha këto dokumente janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
 4. Sipas raportit të njoftimit të datës 7 maj 2008, ekipi i AKP-së e kishte lokalizuar pronën e kërkuar, e cila ishte gjetur të jetë një tokë a papunuar dhe e pa-uzurpuar. Po në këtë datë, AKP-ja ka vendosur një shenjë të kërkesës në pronën e kërkuar. AKP-ja deklaroi se kërkesa ishte publikuar më 5 qershor 2008. Më 17 maj 2010, AKP-ja e ka konfirmuar se njoftimi i pronës së kërkuar ishte i saktë.
 5. Ndërmarrja Shoqërore Kooperativa Bujqësore Përparimi (në tekstin e mëtejme: Pala përgjegjëse në kërkesë 1) ka marrë pjesë në procedurën pranë KKPK-së. Fillimisht, edhe klubi i futbollit B., atëherë i përfaqësuar nga avokati Xh. R., ka dërguar një deklaratë si palë përgjegjëse në kërkesë, por e ka tërhequr këtë deklaratë para se KKPK-ja të vendoste mbi kërkesën.
 6. Pala përgjegjëse në kërkesë 1 ka dorëzuar në AKP një dokument: fletën e pjesshme poseduese nr. 47 të datës 13 maj 2013, ku sipas këtij dokumenti Ndërmarrja Shoqërore Kooperativa Bujqësor-Podujevë është bartëse e së drejtës së pronës shoqërore të ngastrës 238, zona kadastrale e Livadicë, Komuna e Podujevës.
 7. Klubi i futbollit Besiana ka dorëzuar në AKP një kontratë të qiradhënies. Kjo kontratë është lidhur ndërmjet klubit dhe Komunës së Podujevës. Klubi ka dorëzuar disa dokumente tjera ku të gjitha kanë të bëjnë me ngastrën nr. 235 e jo atë nr. 238/1.
 8. KKPK-ja vendosi në vendimin e KKPK-së se pala përgjegjëse në ankesë kishte vërtetuar se ishte pronar i 1/1 së pronës së kërkuar, se ai ka të drejtë legjitime në atë pronë dhe se pala përgjegjëse në kërkesë 1 duhej ta lironte pronën. Në paragrafët 38-42 të vendimit grupor, KKPK-ja jap këto arsye: kërkesa bazohet në provat e siguruar nga pala përgjegjëse në ankesë 1 dhe në mungesë të një mbrojtje të vlefshme nga ana e palës përgjegjëse në kërkesë 1, ajo duhet të pranohet
 9. Vendimi iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 19 qershor 2013, ndërsa palës përgjegjëse në kërkesë më 13 qershor 2013.
 10. Komuna e Podujevës, pala ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 12 korrik 2013. Në letrën e njëjtë të ankesës, pala ankuese po ashtu ishte ankuar kundër vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/A/187/2013 për sa i përkiste kërkesës nga pala përgjegjëse në ankesë nr.

KPA38107 për ngastrën 235. AKP-ja e vulosi 19 korrikun 2013 si datën e pranimit të ankesës në letrën e ankesës. Së bashku me ankesën, pala ankuese ka dorëzuar:

- fletën poseduese në të cilën përmendet ngastra 235 por jo edhe prona e kërkuar,
 - vendimin për ndarjen e ngastrës 235 klubit të futbollit B,
 - procesverbalin e vitit 2002 për matjen mes tjerash të pronës së kërkuar,
 - gjendjen e ngastrës 235,
 - dokumentin ‘Të dhënat e bazës së njësisë’ që ka të bëjë me pronën e kërkuar vetëm sa i përket kulturës,
 - një dokument që nuk ka të bëjë me ndonjë ngastër që tregon se Prona Shoqërore Kooperative Bujqësore në Podujevë është pronar/posedues,
 - fletën poseduese nr. 154 për ngastrën 235,
 - dokumentin ‘Të dhënat e bazës së njësisë’ që ka të bëjë me ngastrën 235,
 - një dokument që i referohet pronës komunale, por jo ndonjë numri të ngastrës, dhe
 - dokumentin ‘gjendja e vjetër’ për ngastrën 235.
11. Ankesa i ishte dorëzuar palës ankuese me postë dhe ishte dërguar me datën 9 tetor 2013.
 12. Asnjë palë tjetër nuk ka marrë pjesë në procedurën e apelit para Gjykatës Supreme.
 13. Gjykata Supreme ia ka dërguar palës ankuese një urdhër gjyqësor. Gjykata Supreme e urdhëron palën ankuese si në vijim:
 1. *Në letrën e ankesës i referohet jo vetëm kërkesës 38107 (në ngastrën 235) por po ashtu kërkesës 38112 (në ngastrën 238/1). AKP-ja sugjeron se ankesa ka të bëjë me të dy kërkesat. Në procedurën para KKPK-së mbi kërkesën 38112, vetëm Kooperativa Bujqësore Përparimi identifikohet si palë përgjegjëse në kërkesë. Pala ankuese duhet të cek nëse Komuna e Podujevës gjithashtu ka synim të paraqesë ankesë kundër vendimit të KKPK-së mbi kërkesën 38112 (ngastra 238/1).*
 2. *Nëse përgjigja ndaj pyetjes 1 është po, pala ankuese duhet të argumentojë, së bashku me provat, pse Komuna e Podujevës ka interes ligjor në këtë lëndë dhe ka të drejtën e ankesës.*
 3. *Nëse përgjigja ndaj pyetjes 1 është po, pala ankuese duhet të argumentojë, së bashku me prova, se ankesa nuk është e vonuar. Gjykata Supreme vëren se në bazë të fletë-dërgesës nga AKP-ja (...) vendimi i KKPK-së për kërkesën 38112 i është dërguar Kooperativës Bujqësore Përparimi më 13 qershor 2013 dhe ankesa, sipas vulës së AKP-së në letrën e ankesës, është pranuar nga AKP-ja më 19 korrik 2013.*
 4. *Nëse përgjigja ndaj pyetjes 1 është po, pala ankuese duhet t’i qartësojë se si bazat e ankesës, që duket se ndërliqhen vetëm me vendimin për kërkesën 38107, mund të ndikojnë në vendimin e KKPK-së mbi kërkesën 38112.*
 14. Pala ankuese iu përgjigj urdhrit me letrën e datës 27 nëntor 2014. Së bashku me këtë letër ai ka paraqitur kopjet e dokumenteve që po ashtu i kishte dorëzuar me ankesë. Përgjigjet që kishte dhënë në pyetjet në urdhrin e gjykatës për aq sa janë relevante janë përmbledhur si në vijim:

15. Në ankesën kundër kërkesës me numër 38107, pala ankuese ka përfshirë gjithashtu edhe ankesën e tij kundër vendimit mbi kërkesën me nr. 38112 lidhur me ngastrën 238/1.
16. Pala ankuese është e interesuar të kundërshtojë vendimet e KKPK-së në të dy kërkesat për arsye se ngastrat përfaqësojnë interes të veçantë për palën ankuese e cila është e përmendur në letrën e ankesës.
17. Baza në këtë ankesë është e ndërlidhur me të dyja kërkesat me nr. 38107 dhe 38112 sepse ka të bëjë me të njëjtën patundshmëri të regjistruar në fletën poseduese nr. 47, zona kadastrale e Livadicës me parcelën kadastrale nr. 235 dhe 238/1.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

18. Ankesa është e papranueshme nëse pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën para KKPK-së, përveç nëse pala ankuese është palë e interesuar e cila nuk e ka pranuar njoftimin e kërkesës dhe përndryshe nuk ka qenë në dijeni dhe nuk ka mundur të jetë në dijeni për kërkesën në mënyrë të arsyeshme para se të paraqiste ankesën (neni 12.1 lidhur me nenet 10.1 – 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme: Ligji/UNMIK 2006/50). Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, pala mund të paraqesë ankesë brenda 30 ditëve nga njoftimi i palës me vendimin e KKPK-së.
19. Pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurë para KKPK-së.
20. Pala ankuese deklaron se ka interes në këtë rast sepse ngastra në këtë rast dhe ngastra në procedurën rreth kërkesës 38107 (për ngastrën 235) kanë një interes të veçantë për të. Në lidhje me pyetjen nëse pala ankuese është palë e interesuar, Gjykata Supreme vjen në përfundim se ky pretendim është i mjaftueshëm pasi që ky pretendim mund të interpretohet në atë mënyrë që pala ankuese ka të drejtë në pronën e kërkuar.
21. Njoftimi i kërkesës është bërë duke vendosur një shenjë në fushë. Përveç kësaj, AKP-ja deklaron se kërkesa ishte publikuar, por dosja nuk përmban ndonjë informacion të mëtutjeshëm rreth publikimit. Nën këto rrethana, Gjykata Supreme vjen në përfundim se pala ankuese nuk ka mundur të jetë në dijeni të kërkesës më herët se nga momenti i paraqitjes së ankesës. Përveç asaj që është vendosur në aktgjykimin e datës 24 gusht 2011, lënda nr. GSK-KPA-A-7/10, Gjykata Supreme konsideron se vendosja e një shenje në pronën e kërkuar nuk është e mjaftueshme për ta llogaritur si veprim që paraqet një përpjekje të arsyeshme të njoftimit të kërkesës me qëllim të pranueshmërisë së kërkesës të parashtruar më vonë, përveç nëse ekzistojnë indikacione se pala (e tretë) ishte njoftuar për kërkesën. Gjykata Supreme nuk ka gjetur në këtë dosje indikacione të

- këtu. Po ashtu nuk mund të konkludohet nga dosja nëse publikim i kërkesës në ndonjë medie është bërë siç duhet në kuptim që pala ankuese ishte në dijeni të kërkesës nëpërmjet publikimit.
22. Po ashtu nuk ka indikacion se pala ankuese ka pritur më shumë se 30 ditë për paraqitjen e ankesës pasi që është njoftuar për kërkesën dhe për vendimin e KKPK-së.
23. Prandaj, ankesa është e pranueshme. Gjykata Supreme nuk merr parasysh nëse letra e ankesës në këtë rast përmban bazën për kundërshtimin e vendimit të KKPK-së siç kërkohet me nenin 178 të Ligjit për Procedurën Kontestimore që është i zbatueshëm në këtë procedurë sipas nenit 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Në këtë drejtim mjafton referimi i shkurtër në bazën e ankesës kundër vendimit mbi kërkesën 38107 (për ngastrën 235) në lëndën 2008/2013 në këtë rast.

Meritat e ankesës

24. KKPK-ja kishte vendosur, në bazë të provave të dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë dhe pala përgjegjëse në kërkesë 1, se pala përgjegjëse në ankesë është pronar i pronës së kërkuar dhe se posedimi ishte humbur si pasojë e konfliktit të armatosur.
25. As në letrën e ankesës e as në përgjigjen në urdhrin e gjykatës, pala ankuese nuk ka paraqitur ndonjë bazë të ankesës që ndërlidhet me pronën e kërkuar dhe që do të mund të ishte si arsye për të nxjerrë një përfundim ndryshe lidhur me kërkesën nga ajo që ka vendosur KKPK-ja.
26. Dokumentet që pala ankuese i ka paraqitur me letrën e ankesës dhe përgjigjen në urdhrin e gjykatës nuk kanë të bëjnë me pronën e kërkuar por me pronën kontestuese në lëndën 208/2015 për kërkesën 38107 (për ngastrën 235) apo ato nuk përmbajnë ndonjë fakt relevant që mund të shpie në një vlerësim tjetër të provave të paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë dhe pala përgjegjëse në kërkesë 1 në AKP/KKPK. Për më tepër, pala ankuese nuk përmendet në ndonjërin nga këto dokumente të ketë pasur të drejtën mbi pronën e kërkuar. Vetëm klubi i futbollit Besiana, i cili e ka tërhequr kërkesën e vet, dhe ndërmarrja shoqërore përmenden në disa dokumente. KKPK-ja tashmë ka dhënë arsyetime bindëse se përse referimi në ndërmarrjen shoqërore dhe në klubin e futbollit në këto dokumente mund të hiqet nga provat e paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë.
27. Prandaj ankesa duhet të refuzohet dhe vendimi i KKPK-së duhet të konfirmohet.

Konkludim

28. Rrjedhimisht, nga arsyet e sipërpërmendura dhe sipas nenit 13.3 të Ligjit UNMIK 2006/50, Gjykata Supreme ka vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

29. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit UNMIK 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it